Nr. 04 prot
Shkodër, 09/02/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**
**KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

# VENDIM

**Nr. 4 Datë 24.01.2018**

**" PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE" SUBJEKTIT "WTS ENERGJI" SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe proçedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", miratimin paraprak Nr.3823/7, datë 01.03.2017 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor të subjektit "WTS ENERGJI" SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**Vendosi:**

1-Miratimin e lejes së subjektit **"WTS ENERGJI" sh.p.k.** me administrator Z.Ermal GJONI, për përdorim të burimit ujor Lumi Cemi i Selcës,degë e Lumit Cemi i Bashkuar për prodhim energjie elektrike në Selcë, Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.
Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC DOBRINJË do të ketë këto të dhëna:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Koordinatat e veprës së marrjes Nr.1: | $X_1$– 43 85 127.9 ; | $Y_1$– 47 08 959.7; | $Z_1$– +460 m; |
| Koordinatat e veprës së marrjes Nr.2: | $X_2$ –43 85 006.4; | $Y_2$- 47 09 105.5; | $Z_2$- +460m; |
| Koordinatat e godinës së centrali: | X – 43 84 790.4; | Y – 47 08 712.4; | Z - +423m; |
| Koordinatat e pikës së shkarkimit: | X – 43 84 790.4; | Y – 47 08 712.4; | Z - +423m; |
| Prurja mesatare e burimit ujor: | $Q_1$mes=2.35m³/sek; | $Q_2$mes=0.452m³/sek; | |
| Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: | $Q_1$llog =2.7 m³/sek; | $Q_2$llog =0.6 m³/sek; | |
| Prurja ekologjike: | $Q_1$ekol= 0.27 m³/sek; | $Q_2$ekol= 0.058 m³/sek; | |
| Prurja që shkarkohet: | Q= 3.3 m³/sek | | |

2-Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.
3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR** **KRYETAR**

**Raimonda GURI** **Çesk MILLJA**